



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 121, datë 15.03.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR PERIUdhËN  
2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

RAPORT  
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARIT  
{...}  
2017-2019

POLI I DREJTËSISË  
RRUGA “ANA KOMNENA”  
TIRANË

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1. A Njohuritë ligjore.

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile, është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi pa qenë e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:*

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, fakt ky i integruar me provat e administruara në gjykim. Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të

gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar, gjykim penal themeli apo seancë paraprake, apo kërkesë me objekt vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet të themelit*), rrethanat e fakteve parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale të cilat në çështjet penale të themelit përbëjnë pjesën hyrëse<sup>1</sup> të arsyetimit ndërsa në vendimet e tjera janë integruar me faktin. Karakteristikë e gjyqtarit në çështjet e themelit është paraqitja në mënyrë të integruar dhe koncize e faktit të provuar në gjykim, si në çështjet penale ashtu edhe në ato civile. Ndërkohë në çështjet penale të seancës paraprake, ndryshe nga pjesa tjetër e vendimeve burim vlerësimi, gjyqtari i kushton më tepër rëndësi elementit përshkrues të fakteve të çështjes, duke integruar dhe shpesh herë cituar përmbajtjen e provave të administruara në dosje<sup>2</sup>. Pavarësisht mënyrës së përshkrimit të fateve të çështjes (*në mënyrë koncize apo të zgjeruar*), gjyqtari në çdo rast referon provat e administruara në gjykim dhe vlerësimin mbi to, në funksion të provueshmërisë së fakteve të pranuar si të provuara gjatë gjykimit si dhe të konkluzioneve mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me llojin e marrëdhënies juridike civile ndërmjet palëve.

Gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje me provat e administruara gjatë gjykimit, në mënyrë me specifike në çështjet në të cilat vlerësimi i tij mbi faktin është i ndryshëm nga ajo çka kanë prezantuar palët<sup>3</sup>. Gjyqtari në nxjerrjen e faktit juridik, bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse por edhe provat e mara kryesisht, apo në kryerjen e akteve të ekspertimeve në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme.<sup>4</sup> Analiza e fakteve të çështjes mungon vetëm në vendimet në të cilat gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale (*shpalljen e mos kompetencës<sup>5</sup> apo pushimin gjykim<sup>6</sup>*), në të cilat gjyqtari nuk referon dhe analizon elementë të faktit por merr drejtpërdrejt në analizë shkakun procedural që i ka dhënë fund gjykimit.

---

<sup>1</sup> Në çështjet penale të themelit, posaçërisht në ato për të cilat është proceduar me gjykim të shkurtuar, gjyqtari fillon arsyetimi me përshkrimin dhe analizën e çështjeve procedurale, sikurse është trajtimi i kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në vendimin nr. 204, datë 28.09.2017, vendimin nr.136, datë 31.05.2018, vendimin nr. 143, datë 15.06.2017, vendimin nr.82, datë 12.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>2</sup> Vendimi 176, datë 23.05.2019 me objekt « pushimin e procedimit penal », vendimi nr. 107, datë 08.04.2019 me objekt « dërgimin e çështjes në gjyq », vendimi nr. 197, datë 27.09.2018 me objekt « pushimin e procedimit penal », vendimi nr. 74, datë 01.10.2018 me objekt « ankim ndaj vendimit të mos fillimit të procedimit penal » .

<sup>3</sup> Vendimi nr. 176, datë 23.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër në të cilin gjyqtari, ndryshe nga sa parashtrihet nga organi i akuzës, analizon faktet edhe në pjesën e vlerësimit të gjykatës, për të konkluduar se ka vend për vijimin e hetimeve dhe ka element të anës objektive të veprës penale; Vendimi nr. 168, datë 13.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër në të cilin faktet e çështjes janë rimarrë në analizë në pjesën e vlerësimit të gjykatës, duke konkluduar se konkluzionet e prokurorisë mbi mungesën e elementëve të anës objektive të veprës penale, referuar provave, janë të pambështetura.

<sup>4</sup>Vendimi nr. 156, datë 28.03.2019, vendimi nr. 124, datë 30.04.2018, vendimi nr. 360, datë 22.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku integrohen konkluzionet e ekspertit psikolog për të përcaktuar faktorët sociale dhe emocionale të fëmijëve të mitur dhe raportet e tyre me prindërit, në funksion të përcaktimit të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 334, datë 26.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 20, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në të gjitha vendimet e analizuara, përveç atyre në të cilat gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale, konstatohet se gjyqtari tregon kujdes, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi apo të fakteve dhe rrethanave që lidhen me cilësimin juridik të faktit objekt shqyrtimi si dhe autorësinë e të pandehurit, në çështjet penale.

#### ***-Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtari, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, shpërblim dëmi, kërkesë për vërtetim fakti juridik*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion por nga ana tjetër orienton edhe arsyetimin dhe vlerësimin e gjykatës në vijim, në funksion të zgjidhjes së çështjes. Nga tërësia e vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se natyra juridike e çështjes në disa raste është identifikuar në mënyrë specifike<sup>7</sup> ndërsa në rastet e tjera, dhe kryesisht në çështjet penale, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi, ku gjyqtari kujdeset të përcaktojë në disa prej vendimeve, edhe funksionin e posaçëm të gjykatës (*kryesisht të gjyqtarit të seancës paraprake në çështjet penale*) në raport me natyrën e gjykimit dhe kompetencat e tij, referuar objektit të gjykimit (*kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal*).

#### ***- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar vendimeve burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave të cilat referojnë në zgjidhjen e

<sup>7</sup> Në vendimin civil me nr. 135, datë 21.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër gjyqtari ka përcaktuar natyrën e marrëdhënies juridike si marrëdhënie detyrimi; Në vendimin civil nr. 92, datë 29.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër gjyqtari ka përcaktuar se në mosmarrëveshjen midis palëve gjen zbatim instituti i begatimit pa shkak.

mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi apo nuk janë në vijim të arsytimit, pjesë e analizës ligjore të gjyqtarit. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale apo për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve me natyrë procedurale, konstatohet se:

(A) Në vendimet civile (përmeshje detyrimi, begatim pa shkak, vërtetim fakti juridik, zgjidhje martesë), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse që kanë lidhje me:

- (i) *Institutin e begatimit pa shkak apo përmeshjen e detyrimeve kontraktore*, duke cituar nenet 655 dhe 658<sup>8</sup> të Kodit Civil që përkufizojnë shpërblimin e dëmit dhe padinë e begatimit pa shkak, nenet 663, 690, 698<sup>9</sup> të Kodit Civil lidhur me kushtet për vlefshmërinë e kontratës, detyrueshmërinë e saj për palët dhe të drejtën e palëve kontraktore për të kërkuar përmeshjen e detyrimeve respektive;
- (ii) *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*<sup>10</sup>, ku identifikon dhe citon dispozitat ligjore të Kodit të Familjes (nenet 15, 6, 132, 133, 143, 146-153, 155, 158, 159, 161, 192, 197, 201, 207 dhe 349 të K. Familjes) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj. Në këto vendime gjyqtari referon si ligj të zbatueshëm edhe nenet 53 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ dhe nenin 3 të Konventës së OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijëve”, lidhur me të drejtën për jetë private dhe familjare dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës;

Në vendimet gjyqësore civile evidentohet citimi ose referimi i dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes ose kërkesat procedurale të palëve apo parimet e gjykimit civil. Konkretisht gjyqtari citon/referon:

- (i) nenin 12 të K.Pr.C lidhur me parimin procedural të barrës së provës në lidhje me faktin krijues të mos shlyerjes së detyrimit nga pala e paditur<sup>11</sup>;
- (ii) nenin 388 të K.Pr.C lidhur me vërtetimin e faktit juridik<sup>12</sup>;
- (iii) nenet 35/3, 36/1, 41, 49, 51 52 të K.Pr.Civile në lidhje me përcaktueshmërinë e juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e çështjes civile<sup>13</sup> apo familjare<sup>14</sup>; Në një rast kur gjyqtari ka disponuar për deklarin e mos kompetencës lëndore, krahas neneve 61 dhe 62 të K.Pr.C, referon edhe nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i

<sup>8</sup> Vendimi nr. 92, datë 29.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 135, datë 21.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 156, datë 28.03.2019, vendimi nr. 124, datë 30.04.2018, vendimi nr. 339, datë 30.10.2017, vendimi nr. 388, datë 30.11.2017 dhe vendimi nr. 360, datë 22.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>11</sup> Vendim nr. 135, datë 21.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 315, datë 12.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 135, datë 21.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>14</sup> Vendimi nr.339, datë 30.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

ndryshuar si dhe referon nenet 1/b, 7, 8/b, 11, 69, 73 të po këtij ligji dhe Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8349, datë 14.10.2013 “Për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative”, në mbështetje të disponimit të tij për përcaktimin e gjykatës kompetente të cilës do ti dërgohen aktet<sup>15</sup>;

(iv) nenin 201 të K.Pr.Civile lidhur me institutin e heqjes dorë nga gjykimi, me pasojë pushimin e tij<sup>16</sup>;

(B) Në vendimet penale, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal objekt akuze, ashtu edhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal. Konkretisht:

- (i) Identifikon dispozitat materiale (nenet 236/2, 291, 199/a/1, 174/1, 130/a, 283/1, 278, 242, 137/1, 297 të K. Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit në çështjet penale burim vlerësimi<sup>17</sup>.
- (ii) Referon dispozitat materiale (nenet 289/1, 186, 155) në funksion të analizës së elementëve ligjore të figurës përkatëse të veprës penale, mbi ekzistencën apo mungesën e përgjegjësisë penale në lidhje me faktin juridik, në funksion të analizës së pranimit ose jo të kërkesës për pushimin e çështjes ndaj personit nën hetim apo identifikimin e faktit penal për të cilin dyshohet personi për të cilin kërkohet caktimi i masës së sigurimit personal (neni 291 i Kodit Penal)<sup>18</sup>;

Përveç dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, gjyqtari citon dhe/ose referon edhe dispozita të pjesës së përgjithshme, lidhur me:

- (iii) nenet 1/b, 12, 14 dhe 17 të Kodit Penal lidhur me identifikimin e detyrave të legjislacionit penal, moshën për përgjegjësi penale, konceptin e fajit, rastet e papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore, në funksion të vlerësimit të elementëve të anës subjektive të veprës penale<sup>19</sup> ;
- (iv) nenet 34, 47, 50, 58-65, 55 të Kodit Penal lidhur me caktimin dhe individualizimin e dënimit penal, qëllimin e dënimit, dënimin me gjobë<sup>20</sup>, bashkimin e dënimeve<sup>21</sup>, etj.<sup>22</sup> ;
- (v) nenet 58, 59, 59/a, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të Kodit Penal, të cilat referohen dhe janë dispozitat e kreut VII të Kodit Penal që parashikon « *alternativat e dënimit me burgim* », ndërkohë që me pas citon nenin 59 të Kodit Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë<sup>23</sup> ; Në një rast, gjyqtari në mbështetje të argumenteve të tij mbi shmangien e përdorimit të dënimit me burgim në

<sup>15</sup> Vendimi nr. 334, datë 26.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 20, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>17</sup> Çështjet penale të themelit, përfshirë edhe ato me objekt “miratim urdhri penal” dhe çështjet me objekt dërgimin në gjyq.

<sup>18</sup> Vendimi nr. 108, datë 21.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>19</sup> Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr. 136, datë 31.05.2017, vendimi nr. 44, datë 27.02.2018 dhe vendimi nr. 121, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>20</sup> Vendimi nr. 143, datë 15.06.2017, vendimi nr. 44, datë 27.02.2018 dhe vendimi nr. 121, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>21</sup> Vendimi nr. 82, datë 12.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>22</sup> Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr. 136, datë 31.05.2017, vendimi nr. 77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 44, datë 27.02.2018 dhe vendimi nr. 121, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>23</sup> Vendimi nr. 77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018.

rastet kur masa të tjera plotësojnë qëllimet e dënimit penal, gjyqtari referon Rekomandimin e Këshillit të Evropës nr. R999)22, në lidhje me mbipopullimin e burgjeve<sup>24</sup>;

Përpos dispozitave materiale të K. Penal, gjyqtari identifikon dhe citon për këtë qëllim edhe ligjet dhe aktet nënligjore të posaçme në ato raste kur vetë fakti penal të referon, në lidhje me:

- (i) *Veprën penale të ndërtimit të paligjshëm*. Duke qenë se neni 199/a i K. Penal është një dispozitë *blankete*, gjyqtari referon dhe citon nenin 3<sup>25</sup> të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, nenin 11 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 lidhur me punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi<sup>26</sup>;
- (ii) *Veprën penale të drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt*. Në lidhje me nenin 291 të Kodit Penal, gjyqtari referon në dispozitat respektive të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë (neni 184 i Kodit Rrugor), të cilat vlerësohet të jenë shkelur në rastin konkret, në kuadër të analizës së elementëve të anës objektive të veprës penale<sup>27</sup>;
- (iii) *Veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*, në kuadër të analizës së elementëve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, gjyqtari identifikon ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope” (nenet 1 dhe 11 të ligjit)<sup>28</sup>;

Në lidhje me identifikimin e *dispozitave procedurale penale*, gjyqtari ka cituar dhe referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit:

- (i) dispozita të ligjit procedural penal (*nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale*) në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës për gjykimin e çështjes;<sup>29</sup>
- (ii) procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe uljen e dënimit në rastet e procedimit me këtë rit të gjykimit të posaçëm (*nenet 403, 405 dhe 406 të K.Pr.Penale*), vlerësimin paraprak të kërkesës në seancë paraprake dhe kufijtë e vlerësimit të saj (*nenet 332/c/3 dhe 332/dh/1/c të K.Pr.P*)<sup>30</sup> apo kushtet ligjore të aplikimit të këtij gjykimi të posaçëm në gjykimet e themelit<sup>31</sup>;
- (iii) *nenet 151 dhe 152 të K.Pr.Penale* në lidhje me ligjshmërinë e marrjes dhe çmuarjen e provave<sup>32</sup> dhe *nenet 190, 393 pg 1 dhe 485 të K.Pr.P* në lidhje me disponimin për provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore<sup>33</sup>;

<sup>24</sup> Vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>25</sup> Gjyqtari i referohet dhe citon piken 20, të nenit 3, në lidhje me përkufizimin e termit “ndërtim” në kuptim të këtij ligji.

<sup>26</sup> Vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>27</sup> Vendimi nr. 77, datë 07.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>28</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>29</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 143, datë 15.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>30</sup> Vendimi nr. 107, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>31</sup> Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr.77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 143, datë 15.06.2017, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>32</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

<sup>33</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr.77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 143, datë 15.06.2017, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.



- (iv) nenet 128, 128/a, 98/3, 99/2, 122, 143, 158/2, 171/5, 182/3, 173/3, 145, 331/2, 332/e/2, 360/3, 401/2, 406/d/3, 426/2 të Kodit të Procedurës Penale të cilat citohen ose referohen në kuadër të përcaktimit të llojeve të pavlefshmërive të akteve, shkaqeve të pavlefshmërisë relative; nenet 130, 36, 37, 38, 52/6, 87/2, 154/2/4, 160/5, 193/3, 194, 201/a/4, 209/3, 226/2, 256/3, 130/a/3/4, 294/a/3, 294/b/2/4, 296/2/3, 332/1, 324/4, 362/2 dhe 406/ë/3 të K.Pr.P në lidhje me papërdorshmërinë e provave dhe rastet e marrjes së provës në mënyrë të paligjshme, në kuadër të vlerësimit të gjyqtarit të seancës paraprake që procedon me shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq<sup>34</sup>;
- (v) nenet 406/a, 406/b, 406/c dhe 406/d të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me rastet e aplikimit të urdhrin penal, rolin dhe kontrollin e gjykatës mbi ligjshmërinë e tij si dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata në këto raste<sup>35</sup>;
- (vi) nenet 332/c, 332/dh, 332/ç, 332/d, 332/ë, 380 të K.Pr.P në lidhje me seancën paraprake në çështjet me objekt “dërgimin e çështjes në gjyq”, paraqitjen e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, rolin e gjyqtarit të seancës paraprake për kontrollin e ligjshmërisë së hetimeve, ligjshmërisë së marrjes së provave, vlerësimin lidhur me plotësinë dhe mjaftueshmërinë e provave, kualifikimin ligjor të faktit penal objekt akuze, formimin dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit, etj.<sup>36</sup>;
- (vii) citon nenet 328, 329/a, 329/b, 329, 329/b të K.Pr.P në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose çështjes, paraqitjen e kërkesës në gjykatë, njoftimin e saj palëve, , afatet dhe gjykatën kompetente (në aspektin funksional) për shqyrtimin e saj, si dhe rastet e pranimit apo mospranimit të saj dhe për pasojë<sup>37</sup>, kthimit për vijimin e hetimeve, duke përcaktuar edhe drejtimin dhe afatin e hetimeve<sup>38</sup>; Në rastin e ankimit ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal (para ndryshimeve të ligjit procedural penal me ligjin nr. 35/2017) gjyqtari referon nenin 329 të K.Pr.P që parashikon rastet e pushimit të procedimit ose akuzës, duke referuar në funksion të evidentimit të funksionit të prokurorisë dhe rëndësisë së kontrollit gjyqësor mbi disponimin e prokurorit për pushimin e procedimit, nenet 148 dhe 42 të Kushtetutës<sup>39</sup>; në vendimin me objekt ankim ndaj vendimit e mos fillimit të procedimit penal krahas referimit të neneve 148 dhe 42 të Kushtetutës, gjyqtari referon nenet 278 dhe 329 të K.Pr.P, në lidhje me kompetencën e gjyqtarit të hetimeve paraprake për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të prokurorisë dhe vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit për mos fillimin e procedimit penal<sup>40</sup>;
- (viii) citon nenin 275 të K.Pr.P në funksion të trajtimit të kërkesës së palës ankuese për rivendosjen e sekuestros dhe rastet e humbjes së fuqisë së saj<sup>41</sup>;
- (ix) në vendimin me objekt vleftësimin e arrestit dhe caktim mase sigurimi, gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së ligjshmërisë së arrestit (nenin 251 dhe 252 të K.Pr.Penale) dhe vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj

<sup>34</sup> Vendimi nr. 107, datë 08.04.2019, vendimi nr. 53, datë 08.02.2018 dhe vendimi nr. 41, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>35</sup> Vendimi nr. 121, datë 27.03.2019 dhe vendimi nr. 44, datë 27.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>36</sup> Vendimi nr. 107, datë 08.04.2019, vendimi nr. 53, datë 08.02.2018 dhe vendimi nr. 41, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>37</sup> Vendimi nr. 168, datë 13.09.2018, vendimi nr. 197, datë 27.09.2018, vendimi nr. 176, datë 23.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>38</sup> Vendimi nr. 168, datë 13.09.2018, vendimi nr. 176, datë 23.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>39</sup> Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Dibër.

<sup>40</sup> Vendimi nr. 74, datë 01.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>41</sup> Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Dibër.

personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit.<sup>42</sup>

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe paraqitjen e tyre në mënyrë koncize, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin ose referimin e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, duhet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*materiale ose procedurale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë në rrjedhë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e normës. Normat ligjore, kryesisht ato materiale por edhe normat procedurale kur ato janë ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes, citohen për të vijuar më pas me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes ose konkluzionin e arritur, pro në disa raste dispozitat aplikohen drejtpërdrejt mbi faktin dhe në mbështetje të konkluzionit, kryesisht në çështje të cilat kanë përfunduar për shkaqe procedurale<sup>43</sup>. Konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teleologjik (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*) dhe atë

<sup>42</sup>Vendimi nr. 108, datë 21.11.2019 i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Dibër.

<sup>43</sup>Në vendimin nr. 20, datë 24.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër neni 201/1 i K.Pr.C që parashikon institutin e heqjes dorë nga gjykimi, vetëm citohet për të kaluar drejtpërdrejt në konkluzionin e gjyqtarit për pushimin e gjykimit të çështjes. Po ashtu në vendimin nr. 334, datë 26.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër gjyqtari citon nenin 62 të K.Pr.C dhe nenin 7 të ligjit nr. 49/2012, lidhur me kompetencën për të vijuar me konkluzionin e tij për deklarimin e mos kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes.

sistematik të normave, të cilin, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave, arrin në konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

*(i) Në vendimet civile:* Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet duke identifikuar në qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në vendimet civile dhe familjare burim vlerësimi, gjyqtari pas citimit të ligjit material të zbatueshëm, ndalet në një interpretim të përmbledhur dhe konciz të dispozitës, për të vijuar më pas drejtpërdrejt me përjasjen e saj mbi faktet e çështjes. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- a) në funksion të përcaktimit të natyrës juridike të mosmarrëveshjes, gjyqtari interpreton nenin 658 të Kodit Civil që parashikon padinë e begatimit pa shkak si dhe marrëdhënien juridike të detyrimit objekt shqyrtimi, duke evidentuar elementët që duhet të përmbushen për lindjen e këtij detyrimi, të tillë si veprimi i të dëmtuarit apo një të treti, dëmi, mungesa e fajit, etj. Interpretimi i nenit 658 të Kodit Civil në raport me nenin 655 të tij, që parashikon institutin e shpërblimit të dëmit, bëhet në funksion të evidentimit të dallimeve mes tyre dhe përcaktimit të shkakut ligjor të padisë në rastin konkret<sup>44</sup>;
- b) analizon shkurtimisht marrëdhënien juridike të detyrimit duke interpretuar nenet 663 dhe 690 të Kodit Civil, duke evidentuar detyrueshmërinë e kushteve kontraktore të përcaktuara me vullnet të lirë të palëve dhe përgjegjësinë që rrjedh si pasojë e mos përmbushjes së tyre<sup>45</sup>;
- c) interpreton dispozitën materiale, nenin 132 të K. Familjes në lidhje me shkaqet e zgjidhjes së martesës. Referuar interpretimit logjik të dispozitës gjyqtari arrin në konkluzionin se përmbushen kushtet e parashikuara në të, si humbja e qëllimit të martesës dhe pamundësia e vazhdimit të jetesës së përbashkët ndërmjet bashkëshortëve. Interpreton dispozitat materiale në lidhje me zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin nga mbarimi i martesës siç është ajo e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe detyrimit për ushqim (*duke referuar dhe interpretuar nenin 158 dhe shkurtimisht nenin 1197 të K. Familjes*), të cilat janë pasoja ligjore që nuk lidhen me kërkimet e palëve<sup>46</sup>.

*(ii) Në vendimet penale:* Interpreton dispozitat materiale të pjesës së posaçme të Kodit Penal (*nenet 297, 130/a/a, 283/1, 278/1, 242, 291, 236/1* ) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, në çështjet penale të themelit dhe në rastet e trajtimit të kërkesave për pushimin e procedimit penal. Në këto raste gjyqtari interpreton teorikisht normën relevante të K. Penal duke bërë një përshkrim të përgjithshëm

<sup>44</sup> Vendimi nr. 92, datë 29.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>45</sup> Vendimi nr. 135, datë 21.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>46</sup> Vendimi nr. 156, datë 28.03.2019, vendimi nr. 124, datë 30.04.2018, vendimi nr. 360, datë 22.11.2018, vendimi nr. 339, datë 30.10.2017 dhe vendimi nr. 388, datë 30.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

në lidhje me elementët e figurës së veprës penale dhe në vijim, duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit<sup>47</sup> apo në funksion të vlerësimit për ekzistencën e shkaqeve të pushimit të procedimit penal apo akuzës, në disa raste<sup>48</sup>. Përgjithësisht konstatohet se dispozitat e Kodit Penal (të pjesës së posaçme) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale e duke u përqendruar në disa raste në analizën e elementëve të (i) anës objektive, duke u ndalur në elementët që përbëjnë anën objektive të veprës penale (veprimi/mosveprimi, mënyra e kryerjes së veprës, koha/vendi etj.)<sup>49</sup> apo format<sup>50</sup> e kryerjes së veprës në raste të caktuara, rrethanat cilësuese<sup>51</sup>, pasojat kur ato përbëjnë element të domosdoshëm për ekzistencën e veprës<sup>52</sup>; (ii) subjektin, duke ndalur sipas rastit në elementë të tillë si moshë për përgjegjësi penale dhe përgjegjshmëria<sup>53</sup> apo elementët që përcaktojnë subjektin e veprës penale si të posaçëm<sup>54</sup>; (iii) anën subjektive, duke u ndalur në elementë të tillë si faji, për të cilin analizon aspektin intelektual dhe vullnetin<sup>55</sup>, dashja<sup>56</sup>, qëllimi<sup>57</sup>, etj. Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit apo për të cilën procedohet është një dispozitë *blankete*, gjyqtari referon në ligjet e posaçme që gjejnë zbatim, duke analizuar dhe interpretuar dispozita të veçanta të tyre<sup>58</sup>.

---

<sup>47</sup> Vendimi nr. 121, datë 27.03.2019, vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr. 77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 143, datë 15.06.2017 dhe vendimi nr. 138, datë 08.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>48</sup> Në vendimin nr. 197, datë 27.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me objekt « pushim procedimi », gjyqtari ka analizuar figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke u ndalur në elementë të anës objektive të saj, formën e kryerjes së veprës, dashjen, qëllimin, etj.

<sup>49</sup> Vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” në të cilin gjyqtari ndalet në analizën e objektit dhe anës objektive të veprës penale konkrete. Vendimi nr. 143, datë 15.06.2017 për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” në të cilin gjyqtari ndalet në analizën teorike të anës objektive të veprës penale duke evidentuar elementët përbërës (veprimi/mosveprimi, mënyra e kryerjes së veprës, koha/vendi etj.) për të kaluar më pas në përcaktimin e tyre mbi figurën konkrete të veprës penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal. E njëjta analizë rezultoi edhe në vendimet nr. 204, datë 28.09.2017 si dhe në vendimet e tjera penale të themelit.

<sup>50</sup> Në vendimin nr. 204, datë 28.09.2017 gjyqtari analizon format e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal (shitja, ofrimi për shitje, marrja, dhënia, transportimi, dërgimi, dorëzimi, shpërndarja, tregtimi) për të konkluduar se në rastin konkret vepra penale është kryer në formën e mbajtjes dhe shitjes së lëndës narkotike. Po ashtu analizon format e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

<sup>51</sup> Po në këtë vendim (nr. 204/2017), në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal gjyqtari ndalet në analizën e elementëve cilësues të tillë si kryerja e veprës në mënyrë të përsëritur ose në praninë e fëmijëve.

<sup>52</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>53</sup> Në të gjitha vendimet penale të themelit gjyqtari analizon dhe interpreton nenet 12 dhe 17 të Kodit Penal të cilat përcaktojnë moshën për përgjegjësi penale dhe përgjegjshmërinë e të pandehurit.

<sup>54</sup> Në vendimin nr. 204, datë 28.09.2017 gjyqtari në analizën e “subjektit” ndalet në analizën e karakterit të posaçëm që ka subjekti në këtë vepër, për shkak të marrëdhënieve familjare që ai ka me viktimën e veprës penale.

<sup>55</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>56</sup> Dashja dhe format e saj analizohen nga gjyqtari në të gjitha vendimet penale të themelit.

<sup>57</sup> Qëllimi evidentohet si element i domosdoshëm i figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal në interpretimin që gjyqtari i bën këtij neni në kuadër të vlerësimit të provueshmërisë ose jo të elementëve të kësaj vepre, në kuadër të trajtimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal, në vendimin nr. 197, datë 27.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>58</sup> Konkretisht në vendimin 136, datë 31.05.2018 gjyqtari referon dhe interpreton nenin 3 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe nenin 11 të Rregullores së miratuar me vendimin nr. 408, datë

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat procedohet, në çdo rast gjyqtari interpreton dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh.: (i) referon dhe interpreton net 12, 14, 17 e vijues të Kodit Penal në lidhje me moshën për përgjegjësi penale, përgjegjshmërinë, format e kryerjes së veprës penale, konceptin e fajit dhe formave të tij, dashjen dhe llojet e saj, etj., në funksion të analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale<sup>59</sup>; (ii) referon dhe interpreton nenet 34, 47, 50, 55 të Kodit Penal në lidhje me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit si dhe evidentimit të faktorëve që shërbejnë për individualizimin dhe përcaktimin e përshtatshmërisë së tij; (iii) interpreton dispozitën materiale penale (nenin 59 të K. Penal), në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, posaçërisht në pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në prove të pandehurit, duke evidentuar qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri një dënim alternativ<sup>60</sup>. Në një rast, në mbështetje të evidentimit të qëllimit të aplikimit të dispozitave lidhur me dënimet alternative, gjyqtari ndalet në përmbajtjen e sentencës së udhëzimit nr.5, datë 15.05.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë mbi dënimin me kusht<sup>61</sup>.

*Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, në rastet kur dispozita procedurale gjen zbatim për çështje të procedurës të vlerësuara kryesisht (si p.sh në lidhje me ligjshmërinë e marrjes së provave apo procedimin me gjykim të shkurtuar në çështjet penale apo në lidhje me vlerësimin e çështjeve të kompetencës dhe juridiksionit të vlerësuara kryesisht, dispozitat procedurale citohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktin apo rrethanën konkrete)<sup>62</sup>. Në vendimet e tjera burim vlerësimi, gjyqtari i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës procedurale përsa i përket aspekteve meritore, kur dispozitat procedurale janë ato që gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes në themel si*

---

13.05.2015 për përkufizimin e termit “ndërtim” dhe analizën e rasteve kur legjislacioni përkatës kërkon pajisjen me leje ndërtimi apo deklarimin e punimeve. Në vendimin nr. 77, datë 07.03.2019 gjyqtari i referohet nenit 184 të Kodit Rrugor për evidentimin e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor që përbëjnë objektin dhe elementë të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Në vendimin nr. 204, datë 28.09.2017 gjyqtari i referohet neneve 1 dhe 11 të ligjit nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, në funksion të analizës të elementëve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal dhe posaçërisht formave të kryerjes së veprës konkrete.

<sup>59</sup> Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr. 136, datë 31.05.2017, vendimi nr. 44, datë 27.02.2018 dhe vendimi nr. 121, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>60</sup> Vendimi nr. 77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>61</sup> Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>62</sup> Shih p.sh vendimet penale nr. Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr.77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 143, datë 15.06.2017, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër në lidhje me gjykimin e shkurtuar apo vendimet civile nr. nr. 20, datë 24.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër neni 201/1 i K.Pr.C ku neni 201 i K.Pr.Civile vetëm citohet për të kaluar drejtpërdrejt në konkluzionin e gjyqarit për pushimin e gjykimit të çështjes dhe vendimin nr. 334, datë 26.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër në të cilin gjyqtari citon nenin 62 të K.Pr.C dhe nenin 7 të ligjit nr. 49/2012, lidhur me kompetencën për të vijuar drejtpërdrejt me konkluzionin e tij për deklarimin e mos kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes.

p.sh çështjet e seancave paraprake<sup>63</sup> apo në kërkesën penale për vleftësimin e arrestit dhe caktimit të masave të sigurimit<sup>64</sup>. Konkretisht:

- a) Në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake me objekt ankim ndaj vendimit të pushimit apo mos fillimit të çështjes, gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë interpretimit të normave procedurale penale (*nenet 278, 329 e vijues të K.Pr.Penale, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017*) në lidhje konceptin e ndjekjes penale, rolin dhe funksionin kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, rolin dhe funksionin e gjykatës në kontrollin e rregullshmërisë, ligjshmërisë së veprimeve hetimore në funksion të garantimit të të drejtave dhe lirive të subjekteve të proceduara apo dëmtuara nga vepra penale si dhe kontrollin dhe vlerësimin e saj në drejtim të kryerjes së një vlerësimi apo hetimi të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me faktin e kallëzuar apo hetuar nga organi i akuzës. Në këto vendime gjyqtari referon dhe interpreton edhe nenin 148 të Kushtetutës që përcakton funksionin kushtetutës të prokurorisë si organ i hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, në emër të shtetit<sup>65</sup>; Në një nga këto vendime, në përgjigje të kërkesës së ankuesit për rivendosjen e sekuestros, gjyqtari referon dhe interpreton nenin 275 të K.Pr.P që parashikon humbjen e fuqisë së sekuestros në rastet e disponimit për pushimin e procedimit penal dhe pamundësinë e rivendosjes së saj nga gjykata edhe në rastet kur ajo disponon për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal<sup>66</sup>;
- b) Në vendimet me objekt *pushimin e procedimit penal*, gjyqtari interpreton dispozitat procedurale që përcaktojnë modalitetet e shqyrtimit të kërkesës (*duke referuar dhe interpretuar nenet 328, 329/a, 329/b të K.Pr.P*), si dhe ndalet në rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kompetencave të tij për kontrollin e hetimeve paraprake në drejtim të ligjshmërisë dhe plotësisë së veprimeve hetimore, ligjshmërisë së vlerësimit të faktit lidhur me kualifikimin ligjor të tij si dhe vlerësimit për ekzistencën dhe provueshmërinë ose jo të elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe kualifikimit ligjor të saj<sup>67</sup>;
- c) Në vendimet me objekt *dërgimin e çështjes në gjyq* gjyqtari referon dhe interpreton dispozitat procedurale (*nenet 128, 128/a, 130, 332/c, 332/dh, 332/ë e vijues të K.Pr.P*) duke evidentuar rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me vlerësimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq në drejtim të vlerësimit të bazueshmërisë në ligj të kërkesës së prokurorisë, vlerësimin mbi mjaftueshmërinë e provave në mbështetje të akuzës, ligjshmërinë e veprimeve hetimore, vlefshmërinë e akteve të hetimit, përdorshmërinë e provave të marra, ekzistencën dhe kualifikimin e duhur ligjor të faktit penal objekt akuze, etj. Po ashtu gjyqtari referon dhe analizon dispozitat procedurale që përcaktojnë funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake në

<sup>63</sup>Vendimi nr. 107, datë 08.04.2019, vendimi nr. 53, datë 08.02.2018 dhe vendimi nr. 41, datë 24.01.2019, vendimi nr. 168, datë 13.09.2018, vendimi nr. 197, datë 27.09.2018, vendimi nr. 176, datë 23.05.2019, etj.

<sup>64</sup>Vendimi nr. 108, datë 21.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>65</sup> Vendimi nr. 18, datë 13.04.2014 dhe nr. 74, datë 01.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, të cilat lidhen me shqyrtimin e ankimeve të palëve lidhur me vendimin e mos fillimit apo pushimit të procedimit penal, para ndryshimeve që K.Pr.P pësoi me ligjin nr. 35/2017.

<sup>66</sup> Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>67</sup> Vendimi nr. 168, datë 13.09.2018, vendimi nr. m178, datë 23.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

drejtim të vlerësimit në aspektin procedural lidhur me paraqitjen e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, formimin dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit, etj.<sup>68</sup>;

- d) Në çështjet me objekt miratimin e *urdhrit penal*, gjyqtari interpreton dispozitat procedurale (nenin 406/a të K.Pr.P) në drejtim të analizës së aspekteve procedurale të gjykimit si dhe në drejtim të evidentimit të elementëve që janë objekt i kontrollit dhe vlerësimit të gjykatës në këto raste, duke u ndalur në rolin e saj për vlerësimin lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit, si dhe ekzistencën ose jo të kushteve ligjore për refuzimin e miratimit të urdhrit penal<sup>69</sup>;
- e) Në kërkesën penale me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, në funksion të vlerësimit lidhur me ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë dhe ekzistencës së kushteve dhe kritereve për caktimin dhe përshtatshmërinë e masave të sigurimit, gjyqtari nuk ndalet vetëm në trajtimin teorik të dispozitave procedurale përkatëse (*nenet 251, 252 dhe 228 dhe 229 të K.Pr.Penale*) por i interpreton ato në përputhje me provat dhe rrethanat e çështjes<sup>70</sup>.

**- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante:**

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet e GJEDNJ-së*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- a) *Parimin e ligjshmërisë* në kuadër të analizës mbi rolin e gjyqtarit në kontrollin e ligjshmërisë së hetimeve në çështjet kur kundërshtohet vendimi për mos fillimin apo pushimin e procedimit penal, duke referuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 06.02.2008, nr. 14, datë 16.07.2008 dhe nbr.5, datë 06.03.2009, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 16.01.2013 dhe nr. 196, datë 04.07.2012<sup>71</sup>;
- b) *Rolin e gjyqtarit të hetimeve paraprake* duke referuar vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013<sup>72</sup>;
- c) *Alternativat e dënimit me burgim*, duke referuar vendimet nr. 151, datë 18.06.2014 dhe nr. 99, datë 09.04.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, udhëzimin e plenumit të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 15.05.1979 mbi dënimin me kusht<sup>73</sup>;

---

<sup>68</sup> *Vendimi nr. 107, datë 08.04.2019, vendimi nr. 53, datë 08.02.2018 dhe nr. 41, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

<sup>69</sup> *Vendimi nr. 44, datë 27.02.2018, vendimi nr. 121, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

<sup>70</sup> *Vendimi nr. 108, datë 21.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

<sup>71</sup> *Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 dhe vendimi nr. 74, datë 01.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

<sup>72</sup> *Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

<sup>73</sup> *Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018 dhe vendimi nr. 77, datë 07.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

- d) *Qëllimin dhe funksionin e dënimit penal*, duke referuar qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese në vendimet nr. 1, datë 12.01.2011, nr. 19, datë 01.06.2011 dhe nr. 47, datë 26.07.2012<sup>74</sup>;
- e) *Gjykimin e shkurtuar*, duke referuar dhe zbatuar vendimin unifikues nr. 2 datë 29.01.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>75</sup>;
- f) *Elementët e anës objektive dhe subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (falsifikimi i dokumenteve)*, duke referuar qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimet nr. 186, datë 05.06.2013, nr. 113, datë 27.03.2013 dhe nr. 617, datë 16.06.2010<sup>76</sup>;
- g) *Dhënien e kuptimit të termit “dozë e vogël” në kuadër të analizës së elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal*, duke referuar vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008<sup>77</sup>;

**- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:**

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtari referon dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit. Gjyqtari njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit siç janë:

- (i) *parimin e ligjshmërisë* së procedimit penal dhe garantimit të të drejtave të subjekteve të procedimit, në kuadër të analizës së rolit të gjykatës në kontrollin e hetimeve paraprake dhe ligjshmërisë së vendimit të mos fillimit apo pushimit të procedimit penal<sup>78</sup>;
- (ii) *parimi i prezumimit të pafajësisë* të sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, në nenin 30 të Kushtetutës apo në nenin 6, pg.2 të KEDNJ-së, dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përgjegjësinë penale të autorit, të bindjes për fajësinë “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” i referuar ose nxjerrë nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit;
- (iii) *përmend parimin e taksativitetit* në funksion të vlerësimit lidhur me pasojat e pavlefshmërisë dhe përcaktimin e tyre nga ligji procedural penal, *si dhe parimet e kontradiktoritetit, pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës* në drejtim të evidentimit të rolit dhe funksionit të gjyqtarit të seancës paraprake në çështjet me objekt “dërgimin në gjyq”<sup>79</sup>;
- (iv) *parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim dispozitat e Kodit të Familjes si dhe duke analizuar pasojat e zgjidhjes së martesës tek fëmijët e mitur, në konsideratë të këtij interesi. Në lidhje

<sup>74</sup> Vendimi nr. 82, datë 12.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>75</sup> Vendimi nr. 143, datë 15.06.2017 dhe vendimi nr. 143, datë 15.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>76</sup> Vendimi nr. 197, datë 27.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>77</sup> Vendimi nr. 204, datë 28.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

<sup>78</sup> Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017, vendimi nr. 74, datë 01.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>79</sup> Vendimi nr. 107, datë 08.04.2019, vendimi nr. 53, datë 08.02.2018 dhe vendimi nr. 41, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.



- me të drejtën e takimit të fëmijëve me prindërit mban në konsideratë edhe të drejtën për jetë familjare<sup>80</sup>;
- (v) parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit si dhe të humanizmit (neni 1/c i K. Penal)<sup>81</sup>;

## **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### **1.B Arsyetimi ligjor**

#### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta, të kuptueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Gjyqtari përdor fjalë me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe koncize. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, fjalëve fyese apo denigruese. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike. Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, parimet apo institutet në përgjithësi përdoren në gjuhën shqipe, dhe në ato raste të përdorimit të termave latine,<sup>82</sup> jepet kuptimi tyre në gjuhën shqipe.

<sup>80</sup>Vendimi nr. 360, datë 22.11.2018, vendimi nr. 388, datë 30.11.2017, vendimi nr. 339, datë 30.10.2017, vendimi nr. 124, datë 30.04.2018 dhe vendimi nr. 156, datë 28.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>81</sup>Vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr. 136, datë 31.05.2018, vendimi nr.77, datë 07.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, etj.

<sup>82</sup>Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi mesatare, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër, nëpërmjet një kalimi të natyrshëm që evidenton qartësinë e të shprehurit të mendimit juridik.

#### **KONKLUSIONE:**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër. Pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Çështje, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) apo CRAC (*Konkluzion, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit përfundimtar një strukturë të qëndrueshme dhe të

---

*konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mos njohësit e ligjit.*

organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet prezantimit të fakteve të çështjes, identifikimit dhe citimit të ligjit të zbatueshëm për të vijuar më tej me analizën dhe argumentimin e gjyqtarit mbi kërkimet objekt padie ose çështjen penale në shqyrtim, për të përfunduar me konkluzionet e arritura. Kjo strukturë ndiqet përgjithësisht në të gjitha vendimet burim vlerësimi, përveç rasteve kur gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale, në të cilat natyra e vendimit dikton ndjekjen e një strukture më të thjeshtë<sup>83</sup>. Gjyqtari ka një metodologji të qartë dhe përgjithësisht të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese, si dhe dispozitivin.

**Në pjesën hyrëse** gjejmë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i mosmarrëveshjes/çështjes, baza ligjore dhe perëndimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur dhe koncize.

**Pjesa përshkuese arsyetuese** është e ndarë në disa pjesë të listuara dhe përgjithësisht të emërtuara me tituj si:

- (i) *procedura* - në pjesën hyrëse të disa prej vendimeve burim vlerësimi gjyqtari pas prezantimit të çështjes, parashtron dhe merr në analizë faktet me natyrë procedurale lidhur me trajtimin e çështjeve të juridiksionit dhe kompetencës<sup>84</sup>, trajtimin të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit<sup>85</sup>, aspektet procedurale të shqyrtimit të çështjes penale, njoftimin dhe pjesëmarrjen e palëve në gjykim në çështjen lidhur me ankimin ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal<sup>86</sup>. Në vendimet e tjera burim vlerësimi pjesa përshkruese arsyetuese e vendimit fillon menjëherë me paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes të provuara në gjykim dhe në dy vendime arsyetimi fillon me referimin në mënyrë të shkurtuar të fakteve me natyrë procedurale (*heqja dorë nga gjykimi apo shqyrtimi i çështjes së kompetencës lëndore*) të cilat kanë sjellë si pasojë përfundimin e gjykimit<sup>87</sup>;
- (ii) *faktet e çështjes*, të cilat përshkruhen dhe analizohen, duke integruar dhe përqasur me njëra tjetrën provat e administruara dhe vlerësuara nga gjykata ose faktin penal të prezantuar nga organi i akuzës në çështjet e seancës paraprake. Në disa raste gjyqtari citon edhe pjesë të përmbajtjes së tyre, kryesisht në çështjet penale të themelit ose në kërkesat e seancës paraprake me objekt « dërgimin e çështjes në gjyq » .

---

<sup>83</sup> Në vendimin nr. 20, datë 24.01.2019 me të cilin është disponuar për pushimin e gjykimit gjyqtari prezanton çështjen, referon faktin e heqjes dorë nga gjykimi, citon dispozitën ligjore të zbatueshme dhe jep menjëherë pas saj konkluzionin. Në vendimin nr. 334, datë 26.10.2017, nëpërmjet të cilit është disponuar për deklarimin e moskompetencës lëndore, gjyqtari referon çështjen, shqyrtimin prej tij të çështjes së kompetencës, citon ligjin e zbatueshëm, për të vijuar me analizën e tij mbi natyrën e mosmarrëveshjes dhe konkluzionin e arritur lidhur me kompetencën lëndore.

<sup>84</sup> Vendimi nr. 143, datë 15.06.2017, vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 138, datë 08.06.2017, vendimi nr. 135, datë 21.03.2019, vendimi nr. 315, datë 12.10.2017, vendimi nr. 339, datë 30.10.2017, vendimi nr. 360, datë 22.11.2018, vendimi nr. 124, datë 30.04.2018, vendimi nr. 156, datë 28.03.2019, vendimi nr. 388, datë 30.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>85</sup> Vendimi nr. 136, datë 31.05.2018, vendimi nr. 143, datë 15.06.2017, vendimi nr. 77, datë 07.03.2019, vendimi nr. 82, datë 12.03.2019, vendimi nr. 204, datë 28.09.2017, vendimi nr. 138, datë 08.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>86</sup> Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>87</sup> Vendimi nr. 20, datë 24.01.2019 dhe vendimi nr. 334, datë 26.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

(iii) *vlerësimi dhe analiza juridike* në të cilën përfshihet edhe citimi ose referimi i ligjit të zbatueshëm, për të vijuar me interpretimin e tij dhe aplikimin mbi faktet e çështjes konkrete dhe argumentimin mbi mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet konkrete. Në këtë pjesë, gjyqtari ndjek strukturimin nëpërmjet nënndarjeve të identifikuara me tituj ose fjali tematike, sipas përmbajtjes, duke marrë në shqyrtim çdo çështje të vlerësuar si të nevojshme prej ti, në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në këtë pjesë të vendimit, referuar objektit të çështjesh, gjyqtari merr në analizë : - aspektet juridike të ankimit ndaj vendimit të pushimit/mos fillimit të procedimit penal dhe aplikimin e tyre mbi faktet e çështjesh konkrete, për të përfunduar me konkluzionin për pranimin ose rrëzimin e ankimit<sup>88</sup> ; - ligji zbatueshëm dhe aplikimi i tij mbi faktin penal objekt akuze, duke analizuar të katër elementët e veprës penale për të cilën procedohet si dhe analiza ligjore dhe faktike lidhur me kriteret për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit si dhe aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, sipas rastit<sup>89</sup> ; - aspektet juridike të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal, roli i gjyqtarit të seancës paraprake, vlerësimi lidhur me aspekte të pavlefshmërisë së akteve, papërdorshmerisë së provave, vlerësimi lidhur me ekzistencën e përgjegjësisë penale, kualifikimin ligjor të faktit penal si dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit ose konkluzioni për bazueshmërinë ose jo të kërkesës për pushim të procedimit, dhe sipas rastit përcaktimi i detyrave dhe kohës së përmbushjes së tyre, në rastet kur çështja është kthyer për hetime të mëtejshme<sup>90</sup> ; - citimi dhe analiza e ligjit të zbatueshëm si dhe aplikimi e tij mbi faktet e çështjesh konkrete, në çështjet civile dhe familjare, duke marrë në analizë kërkimet objekt padie ose çështjet objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në rastet e padive për zgjidhje martese<sup>91</sup>.

***Në pjesën e dispozitivit*** gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i qartë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë/kërkesës*), apo në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor*), dënimin dhe masën e dënimit, por njëkohësisht disponimet lidhur me mënyrën e ekzekutimit të vendimit të dënimit në rastin e aplikimit të dënimeve alternative, formimin dhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit në çështjet e seancës paraprake, përcaktimin e afatit brenda të cilit duhet të përmbushen detyrat e lëna nga gjykata në çështje të kësaj kategorie të kthyer për vijimin e hetimeve, etj. Gjithashtu në të gjitha vendimet burim vlerësimi pasqyrohet disponimi mbi shpenzimet gjyqësore, mbi provat materiale në çështjet penale të themelit, si dhe e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Përveç ndarjes në pjesë, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë, çka lehtëson kuptueshmërinë e arsytimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare. Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, konkretisht në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 245 të K.Pr.Penale në vendimin e kërkesës së

<sup>88</sup> *Vendimi nr. 18, datë 13.04.2017 dhe vendimi nr. 74, datë 01.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

<sup>89</sup> *Të gjitha vendimet penale të themelit.*

<sup>90</sup> *Vendimet e seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjesh në gjyq ose pushimin e procedimit penal.*

<sup>91</sup> *Vendimet civile të themelit dhe vendimet për çështjet familjare.*

hetimeve paraprake, (iii) nenin 332/e apo 329/b të K.Pr.Penale në vendimet seancë paraprake apo (iv) nenit 383 të K.Pr.Penale në vendimet penale.

#### **KONKLUSIONE:**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor. Gjyqtari përdor një metodë të caktuar në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje e cila, në varësi të kategorisë së çështjes apo natyrës së vendimit, ndjek përgjithësisht rregullin (i) fakt, (ii) ligj, (iii) arsytim dhe (iv) konkluzion.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

#### ***1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme<sup>92</sup>. Ndonëse nuk kërkohet shprehimisht në nenin 6 të KEDNj-së, e drejta e një vendimi të arsyetuar bën pjesë në të drejtën e një gjykimi të drejtë siç garantohet nga neni 6, pika 1 i KEDNj-së, dhe gjen zbatim si në çështjet civile ashtu dhe ato penale. GjEDNj-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.<sup>93</sup> Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj, provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete. Analiza e fakteve të çështjes është paraqitur në mënyrë të shkurtër vetëm në

<sup>92</sup> Neni 142 i Kushtetutës së RSH-së.

<sup>93</sup> Vendimi i GjEDNJ, Çështja “Suominen kundër Finlandës”, 24 korrik 2003, paragrafët 34-38 si dhe çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33

vendimet me objekt “zgjidhje martesë”, por ndërkohe elementë të faktit janë pjesë e pjesës arsyetuese dhe paraqiten për herë të parë në atë pjesë të vendimit. Ndërkohë në çështjet të cilat kanë përfunduar për shkaqe procedurale (*pushim ose deklarim moskompetence*) gjyqtari referon vetëm faktet me natyrë procedurale të marra në shqyrtim, pa parashtruar faktin objekt mosmarrëveshje, për shkak se vendimi gjyqësor nuk zgjidh çështjen në themel<sup>94</sup>.

Përveç paraqitjes dhe analizës së fakteve të çështjes, së bashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, fakte të caktuara dhe me rëndësi në raport me argumentet e gjyqtarit, rimerren sërish në analizë, në mënyrë të integruar me analizën e ligjit, në pjesën e arsyetimit të vendimit që përbën argumentet e gjykatës për zgjidhjen e çështjesh.

Në vendimet përfundimtare për çështjet civile me palë kundërshtare, gjyqtari analizon kërkimet objekt padie duke shtjelluar arsyet e konkluzionit të arritur në lidhje me padinë, sipas një analize të integruar të ligjit me rrethanat e faktit, në funksion të drejtpërdrejtë të konkluzioneve të tij. Në vendimet penale, gjyqtari merr në analizë çështjet e vlerësuara si të nevojshme, referuar natyrës së çështjes, në funksion të analizës së tij mbi ekzistencën e veprës penale, përgjegjësinë penale të të pandehurit, individualizimin e dënimit, analizën e ligjshmërisë së kërkesës për dërgimin e çështjesh në gjyq, pushimin e procedimit penal apo caktimin e masave të sigurimit, duke u ndalur fillimisht në referimin dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm procedural ose material, dhe më pas në përjasjen e tij me faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar gjatë gjykimit.

Duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, duke dhënë argumente lidhur me secilin kërkim apo çështje të vlerësuar thelbësore në dobi të zgjidhjes përfundimtare, dhe duke u ndalur në interpretimin e ligjit dhe aplikimin e tij mbi faktet konkrete si dhe evidentimin e lidhjes shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit të zbatueshëm dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtari lidhur me zgjidhjen e çështjesh.

Në vendimet civile të themelit, gjyqtari analizon dhe lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkimet objekt padie ose pretendimet e palëve, me faktin e provuar në gjykim si dhe me argumentin ligjor konkret, duke evidentuar lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim me konkluzionin e tij për bazueshmërinë ose jo të pretendimeve nga pikëpamja ligjore. Në një rast, kur gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale (heqje dorë nga gjykimi), gjyqtari citon nenin 201 të K.Pr.C dhe kalon në mënyrë të drejtpërdrejtë në konkluzionin mbi pushimin e çështjesh, pa dhënë asnjë argument mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi rrethanën procedurale objekt vlerësimi, pavarësisht natyrës tërësisht procedurale dhe jo komplekse të vendimit në këtë rast<sup>95</sup>.

---

<sup>94</sup> Vendimi nr. 20, datë 24.01.2019 dhe vendimi nr. 334, datë 26.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>95</sup> Vendimi nr. 20, datë 24.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në vendimet penale, referuar natyrës së tyre (gjkime themeli apo çështje të seancës paraprake ose ankim ndaj vendimit të pushimit/mos fillimit të procedimit penal) analiza ligjore zhvillohet duke zbërthyer normën ligjore të zbatueshme, duke u ndalur në disa vendime në analizën e konceptit të ndjelljes penale, rolit të gjyqtarit të hetimit paraprak apo seancës paraprake me qëllim përcaktimin e qartë të kompetencave të tij në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së veprimeve hetimore të prokurorisë dhe ligjshmërisë së vendimit<sup>96</sup> apo kërkesës objekt shqyrtimi. Përcaktimi në mënyrë të qartë i rolit të gjyqtarit në këto vendime, shërben më pas si bazë për zhvillimin dhe arsyetimit mbi ato drejtime që janë përcaktuar paraprakisht lidhur me rolin e gjyqtarit të hetimit apo seancës paraprake.

Në vendimet e seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton se analiza teorike e ligjit të zbatueshëm është dominuese në raport me analizën e gjyqtarit mbi faktet e çështjes konkrete të cilat përgjithësisht paraqiten në formën e një konkluzioni të organizuar në një ose disa paragrafë, pas analizës teorike të ligjit të zbatueshëm, kushtëzuar kjo edhe nga natyra kryesisht procedurale e vendimit të seancës paraprake. Në këto vendime komponenti analitik bazohet kryesisht në interpretim teorik të ligjit të zbatueshëm dhe konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, ndërkohë që analiza e konkretizuar në raport me faktet e çështjes dhe marrëdhënien shkak-pasojë zë një peshë më të vogël në raport me pjesën tjetër të arsyetimit pasi gjyqtari parashtron në formën e konkluzioneve arsytet e vlerësimit të tij në raport me ligjin e zbatueshëm, diktuar nga objekti i çështjes dhe roli i gjyqtarit të seancës paraprake, të cilin gjyqtari është kujdesur ta evidentojë qartë në analizën teorike të tij, si një rol me karakter kryesisht procedural<sup>97</sup>.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, gjyqtari përgjithësisht i kushton vëmendje marrjes në analizë të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, duke i dhënë përgjigje të argumentuar. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, jo në një pjesë të veçuar të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, këto të fundit marrin një përgjigje të argumentuar, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit të vendimit.

#### **KONKLUZIONE:**

*Në tërësi*, analiza ligjore si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjykimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimit të atyre, ashtu edhe ajo ligjore e veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë dhe gjithëpërfshirëse, duke u pasuruar në disa raste edhe me interpretim të pavarur të ligjit si dhe qëndrime të praktikës gjyqësore.

---

<sup>96</sup> Në dy raste objekt shqyrtimi ka qenë ligjshmëria e vendimit të mos fillimit dhe pushimit të procedimit penal, ndërsa në rastet e tjera ligjshmëria e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq ose për pushimin e procedimit penal.

<sup>97</sup> Vendimi nr. 41, datë 24.01.2019, vendimi nr. 107, datë 08.04.2019, vendimi nr. 53, datë 08.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

### **Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.**

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## **2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### **2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.**

#### **2.A.a Respektimi i afateve ligjore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit 2017-2019, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 513 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “familjare me palë kundërshtarë”, “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”, “çështje penale të seancës paraprake” dhe “civile pa palë kundërshtarë”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 513 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 70 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 443 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (70 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (513 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 13.6 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.



Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari parashtron se në çështjet me objekt “zëvendësim mase sigurimi” seanca gjyqësore gjithmonë është caktuar brenda afatit 5 ditor, por në disa raste seanca është shtyrë për shkak të kërkesave të palëve dhe seancat pasardhëse janë caktuar brenda afateve të shkurtra. Në çështjet e seancës paraprake me objekt “dërgimin në gjyq” afati i gjykimit 30 ditë është tejkualuar në disa raste për arsye objektive që lidhen me njoftimin e palëve, pasaktësi në adresa, vonesa në kryerjen e njoftimeve, kërkesa të palëve për tu njohur me aktet apo për të siguruar mbrojtje, etj. Po ashtu në këtë kategori çështjes bëjnë pjesë edhe çështjet të cilat janë kthyer për plotësimin e hetimeve, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin 30 ditor të shqyrtimit. Në çështjet me objekt “ankim ndaj vendimit të mos fillimit” për të cilat gjykimi ka përfunduar tej afatit, planifikimi i tyre ka qenë gjithnjë në kohë shumë të shkurtër, por shtyrja e seancës së parë dhe seancave vijuese ka qenë gjithnjë për shkaqe procedurale, me qëllim garantimin e të drejtave të palëve. Lidhur me kërkesat me objekt “caktim mase sigurimi” neni 244 i K.Pr.P nuk ka parashikuar afat ligjor brenda të cilit ato duhet të shqyrtohen dhe për pasojë ato janë gjykuar brenda një afati 5 ditor. Gjithashtu disa çështje rezultojnë se janë llogaritur jashtë afatit ligjor duke përfshirë edhe periudhën e lejes së zakonshme vjetore prej 35 ditësh. Po ashtu duhet të mbahet parasysh veç shkaqeve si më sipër, edhe ngarkesa në punë që ka ndikuar në këtë tregues, si dhe fakti që tejkualimi i afateve ligjore nuk ka ardhur në asnjë rast për shkak të neglizhencës<sup>98</sup>.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 70 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezultojnë se:

- (i) në çështjet me objekt “lëshim i urdhrit të mbrojtjes”, neni 16 i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, parashikon afatin 15 ditor të shqyrtimit<sup>99</sup>. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezultojnë se çështja me nr. rendor 3, tabela nr.3, viti 2017, çështja ka përfunduar për 21 ditë, duke tejkualuar afatin ligjor me vetëm 6 ditë. Po ashtu çështjet me nr. rendor 40 dhe 41, tabela nr. 3, viti 2018, kanë përfunduar për 28 ditë, ndërkohe që në çështjet me objekt “verifikim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, referuar neneve 18 dhe 19 të ligjit nr. 9669/2006, derivon afati ligjor i shqyrtimit 22 ditë. Këto dy çështje rezultojnë se kanë tejkualuar afatin ligjor me vetëm 6 ditë.
- (ii) në çështjet me objekt “caktim mase sigurimi”, për të cilat neni 244 në lidhje me nenin 260 të K.Pr.Penale parashikon afatin 5 ditor për shqyrtimin e kërkesës, në raportin

<sup>98</sup>Gjyqtari ka referuar shpjegimet si më sipër, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë projektraport, por që parashtrihen në mënyrë të detajuar në raportin analitik, faqe 29 dhe 30, por pa u referuar në çështje konkrete.

<sup>99</sup> Ky afat ligjor ka qenë në fuqi në gjithë periudhën e vlerësimit 2017-2019, pasi neni 16, pika 1 i ligjit, pavarësisht ndryshimit që ka pësuar formulimi i tij me ligjin nr. 47/2018, lidhur me afatin ligjor 15/ditor nuk ka pësuar ndryshime. Konkretisht, para ndryshimeve me ligjin nr. 47/2018, neni 16 pika 1 parashikonte të njëjtin afat ligjor 15 ditor, por formulimi i tij ka qenë i ndryshëm. Para ndryshimeve neni kishte këtë formulim “Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës. ”, ndërsa pas ndryshimeve që kanë hyrë në fuqi në datë 18 gusht 2018, ky nen ka këtë formulim “Gjykata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.”.

analitik rezulton se janë konstatuar tej afatit *çështja me nr. rendor 24 dhe 25, tabela nr. 10, viti 2017, çështja me nr. rendor 6, tabela nr.10, viti 2018 dhe çështja me nr. rendor 35, tabela nr.10, viti 2019*, duke konsideruar afatin ligjor të shqyrtimit 48 orë. Nëse do ti referohemi afatit 5 ditor, duke konsideruar parashikimet e nenit 244 në lidhje me nenin 260 të K.Pr.P<sup>100</sup>, rezulton se këto kërkesa janë shqyrtuar për 4 dhe 5 ditë nga data e regjistrimit të tyre. Referuar afatit ligjor 5 ditor për shqyrtimin e kërkesës, rezulton se këto 4 çështje janë gjykuar për 4 deri në 5 ditë, pra brenda afatit ligjor dhe për pasojë duhet të zbriten nga numri i çështjeve të konsideruara si të përfunduara jashtë afatit ligjor.

- (iii) në çështjet me objekt «*ankim ndaj vendimit të mos fillimit të procedimit penal* », për të cilat neni 291, pika 3 të K.Pr.P parashikohet afati 30 ditor i gjykimit, rezulton se *çështja me nr. rendor 27, tabela nr. 10, viti 2018* ka përfunduar për 31 ditë, duke kaluar afatin ligjor 30 ditor me vetëm 1 ditë.
- (iv) në çështjet me objekt “*dërgimin e çështjes në gjyq*”, për të cilat në nenin 332/3 të K.Pr.Penale parashikon afatin 30 ditor të gjykimit, rezulton se *çështjet me nr. rendor 16 dhe 21, tabela nr. 11, viti 2017* kanë përfunduar përkatësisht për 34 dhe 36 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me vetëm 4 dhe 6 ditë; *çështjet me numër rendor 19, 25, 30, 31, 36, 37, 48, 50, 72 dhe 74* (10 çështje) kanë përfunduar për 31 deri në 36 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me vetëm 1 deri në 6 ditë; *çështjet me numër rendor 10, 11, 35, 36, 44, 50 dhe 67* (7 çështje) kanë përfunduar për 32 deri në 35 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me vetëm 2 deri në 5 ditë.

Nëse në numrin e çështjeve të përfunduara jashtë afatit ligjor do të zbriten çështjet e analizuar si më sipër, për të cilat rezulton tejkalimi i afatit ligjor me vetëm 1 deri në 6 ditë si dhe çështjet me objekt “*caktim mase sigurimi*” për të cilat siç u analizuar më lart, rezulton se janë shqyrtuar brenda afatit 5 ditor, rezulton se numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor do të rezultonte 43 çështje. Nëse do të përllogaritet raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (43 çështje) pas analizës së më sipër, me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (513 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 8.3 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, do të përjashtoheshin çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*1 deri në 6 ditë*), si

---

<sup>100</sup> Në nenin 244 të K.Pr.P nuk parashikohet afat për shqyrtimin e kërkesës për caktim mase sigurimi ndërsa në nenin 260, pika 4 të K.Pr.P parashikohet se :” 4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj.”.

dhe çështjet me objekt “caktim mase sigurimi”, duke përlllogaritur si afat ligjor atë 5/ditor, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 43 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (43 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (513 çështje), rezulton të jetë **8.3 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor.**

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, brenda marzhit “0-10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 855 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (280 çështje në vitin 2017, 259 çështje në vitin 2018 dhe 316 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprake-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 855 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 132 prej tyre ose **15.4 % janë gjykuar tej standardit** minimal kohor në fuqi.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit, pasqyruar edhe në raportin analitik, ka referuar në çështjet e kategorisë “kundërvajtje penale”, rezulton në disa raste tejkalimi i afatit në çështjet të cilat iniciohen nga i dëmtuari akuzues në të cilat gjykimi ka zgjatur për shkaqe procedurale që lidhen me njoftimin e palëve, paraqitjen e provave, njoftimit të dëmtarëve, etj. Në çështjet e tjera penale tejkalimi i afatit standard ka ardhur për shkaqe procedurale që lidhen me sjelljen dhe kërkesat e palëve si dhe kryerjen e veprimeve të

*nevojshme procedurale në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor. Lidhur me çështjet e seancës paraprake shkaku i tejkalimit të afatit lidhet kryesisht me pamundësinë e njoftimit të palëve (person nën hetim, viktime e veprës penale) për të cilat në dosjen penale nuk ka pasur adresa të sakta dhe kjo ka sjellë vështirësi në njoftimin e tyre.*

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 132 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtari (*muaj gusht i vitit 2017, vitit 2018 dhe viti 2019*). Nëse në përllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtari ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

**(i) Për kategorinë “civile me palë kundërshtare”, rezulton se:**

- çështja me numër rendor 9 (tabela 1, viti 2017), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 28.07.2016 dhe ka përfunduar në datën 27.02.2017 (214 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2016 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 179 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 6 muaj (180 ditë) për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 3 (1 çështje) (tabela 1, viti 2018) rezulton se ka përfunduar për 182 ditë nga data e caktimit me short, duke tejkaluar afatin standard prej 6 muaj (180 ditë) me vetëm 2 ditë;

**(ii) Për kategorinë “civile pa palë kundërshtare”, rezulton se:**

- çështjet me numër rendor 31, 34, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44 ( 11 çështje) (tabela 2, viti 2017), i janë caktuar gjyqtarit me short në muajt qershor dhe korrik të vitit 2017 dhe kanë përfunduar në muajt shtator dhe tetor të po këtij viti, përkatësisht për 98, 91, 70, 77, 77, 84, 84, 63, 67, 77, 88 dhe 66 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2017 (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit 60 ditë dhe vetëm në një rast duke tejkaluar këtë afat me 3 ditë<sup>101</sup>, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare; Në këtë kategori çështjes rezultojnë edhe çështjet me numër rendor 26 dhe 47 (2 çështje), të cilat kanë përfunduar për 63 dhe 66 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 dhe 6 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;
- çështjet me numër rendor 14 dhe 15 ( 2 çështje) (tabela 2, viti 2018), i janë caktuar gjyqtarit me short në muajt qershor dhe korrik të vitit 2017 dhe kanë përfunduar në muajin shtator të po këtij viti, përkatësisht për 87 dhe 94 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2018 (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit 60 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare; Në këtë kategori çështjesh rezulton edhe çështja me numër rendor 3, e cila ka përfunduar për 63ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;
- çështjet me numër rendor 16 dhe 17 ( 2 çështje) (tabela 2, viti 2018), i janë caktuar gjyqtarit me short në muajt qershor dhe korrik të vitit 2017 dhe kanë përfunduar në

<sup>101</sup> çështja me nr. rendor 31, tabela nr. 2, viti 2017 e cila ka përfunduar për 98 ditë.

muajin shtator dhe tetor të po këtij viti, përkatësisht për 95 dhe 66 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2019 (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit 60 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare; Në këtë kategori çështjesh rezulton edhe çështja me numër rendor 10, e cila ka përfunduar për 63 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;

**(iii) Për kategorinë “familjare me palë kundërshtare”, rezulton se:**

- çështjet me numër rendor 4 dhe 35 (2 çështje) (tabela 3, viti 2017), kanë përfunduar për 126 ditë, duke tejkaluar me vetëm 6 ditë afatin standard prej 4 muaj ose 120 ditë;

**(iv) Për kategorinë “familjare pa palë kundërshtare”, rezulton se:**

- çështjet me numër rendor 4 dhe 6 (2 çështje) (tabela 4, viti 2019), kanë përfunduar për 66 dhe 63 ditë, duke tejkaluar me vetëm 6 dhe 3 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;

**(v) Për kategorinë “penale kundërvajtje”, rezulton se :**

- çështja me numër rendor 11 (1 çështje) (tabela 9, viti 2017), ka përfunduar për 126 ditë, duke tejkaluar me vetëm 6 ditë afatin standard prej 4 muaj ose 120 ditë;
- çështja me numër rendor 5 (1 çështje) (tabela 9, viti 2018), ka përfunduar për 122 ditë, duke tejkaluar me vetëm 2 ditë afatin standard prej 4 muaj ose 120 ditë;

**(vi) Për kategorinë “penale seancë paraprake”, rezulton se :**

- çështja me numër rendor 3 (1 çështje) (tabela 11, viti 2017), ka përfunduar për 63 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;
- çështjet me numër rendor 52, 53, 56, 57, 58 dhe 60 ( 6 çështje) (tabela 11, viti 2018), i janë caktuar gjyqtarit me short në muajt qershor dhe korrik të vitit 2018 dhe kanë përfunduar në muajt shtator dhe tetor të po këtij viti, përkatësisht për 88, 77, 81 ose 70 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore në vitin 2018 (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit 60 ditë, pra brenda standardit minimal kohor 2 muaj ose 60 ditë;

Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin çështjet e analizuara më sipër për të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 1 deri në 6 ditë, rezulton se nga 855 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 98 prej tyre ose **11.4 % janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport

me numrin total të çështjeve të gjykuara, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi sesa ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pra, në nivelin 0-10 %, duke e pikëzuar me 5 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë dhe vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është *më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*. Konkretisht:

- i. Në kategorinë e çështjeve “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 186 ditë (6 muaj e 6 ditë), pra **e gjatë** se standardin minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj, por *duke tejkaluar këtë afat me vetëm 6 ditë*;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 35 ditë ( 1 muaj e 5 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 72 ditë (2 muaj e 12 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 41 ditë (1 muaj e 11 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 103 ditë (3 muaj e 13 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “*penale-krime*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 63 ditë (2 muaj e 3 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “*penale-kundërvajtje*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 74 ditë (2 muaj e 14 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve “*kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 11 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;

- ix. Në kategorinë e çështjeve “*seancë paraprake*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 41 ditë (1 muaj e 11 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 58 ditë (1 muaj e 28 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke dhënë edhe shpjegime specifike për katër çështje, duke përshkruar specifikat e gjykimit të tyre, që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit.

#### **KONKLUZIONE:**

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.<sup>102</sup> Referuar metodologjisë, duke qenë se për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” ku standardi minimal kohor është tejkaluar me vetëm 6 ditë, çka vlerësohet tejkallim i papërfillshëm, gjyqtari pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

#### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1368 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1572 çështje) brenda periudhë 3/vjeçare të vlerësimit, **është 87 %**, përqindje e cila pikëzohet me 6 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkaqe që kanë ndikuar në likuidimin e çështjeve *regjistrimin e një*

<sup>102</sup> *Metodologjia e Pikëzimit për ketë tregues parashikon se :”... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.*

*numri të lartë çështjes në fund të vitit kalendarik si dhe moskryerjen e veprimeve në sistem nga administrata e gjykatës për rreth 2 javë në fillim të çdo viti, për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve si dhe pezullimi i çështjeve penale për shkak të pamundësisë për të njoftuar të pandehurin, të cilat kalojnë në fund të vitit si çështje të mbartura.*

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se : *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli. “Sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale themeli dhe çështjes civile me palë kundërshtare. Ndërkohë rezulton se gjyqtari, në tre vite periudhës së vlerësimit ka përfunduar:*

- (i) për vitin 2017 ka përfunduar 237 çështje me palë kundërshtare, duke tejkalluar me 37 çështje ose 18 % standardin sasior;*
- (ii) për vitin 2018 ka përfunduar 278 çështje me palë kundërshtare, duke tejkalluar me 78 çështje ose 39 % standardin sasior;*
- (iii) për vitin 2019 ka përfunduar 274 çështje themeli, duke tejkalluar me 74 çështje ose 37 % standardin sasior. Në vitin 2019, prej datës 28.02.2019 gjyqtari ka ushtruar detyrën e kryetarit të gjykatës, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit të kryetarit në detyrë. Për pasojë, për 10 muaj të vitit 2019, në referim të pikës 3, shkronja h) të aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, standardi sasior i zbatueshëm është 80 çështje në vit, ose 67 çështje për 10 muaj (40 % e ngarkesës minimale të gjyqtarit të së njëjtës gjykatë). Nëse do ti referohemi këtij standardi sasior, për vitin 2019, rezulton se gjyqtari e ka tejkalluar standardin sasior me rreth 240 % për periudhën 10 mujore të vitit 2019, në të cilën ai ka ushtruar dhe detyrën e kryetarit të gjykatës.*

Në total për të tre vitet e plota te punës, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 789 çështje me palë kundërshtare, duke tejkalluar me 189 çështje ose me rreth 31 % standardin sasior në fuqi. Duke përlloritur periudhën 10/mujore të ushtrimit të detyrës së kryetarit, në raport me standardin sasior të zbatueshëm në këtë rast, rezulton se gjyqtari ka tejkalluar standardin sasior të zbatueshëm me 289 çështje, ose 58 % (57.8 %).

#### **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 87 %, por duke konsideruar ngarkesën në punë të gjyqtarit dhe shpjegimet e gjyqtarit për rritjen e papritur të numrit të çështjeve të reja, rezulton se ai ka tejkalluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara, me 58 % si dhe ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare (579 çështje). Për këto arsye bazuar



në analizën logjike të të dhënave, vlerësohet se shkalla e aftësisë duhet të pikëzohet në dy nivele më të larta pikëzimi se sa rezulton nga përlllogaritja matematikore.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet në dy nivele më të larta pikëzimi se ai që përkon me rendimentin në masën 87 %, duke u pikëzuar me 10 pikë, për shkak të tejkalimit të standardit sasior në masën 58%.

#### **2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- (i) Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 12 ditë, më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (ii) Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (iii) Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 11 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (iv) Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 12.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (v) Për çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 11.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (vi) Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsytimit është 18.05 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 16 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- (vii) Për çështje të kategorisë “*penale-krime*”, koha mesatare e arsytimit është 18 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale;
- (viii) Për çështje të kategorisë “*penale-kundërvajtje*”, koha mesatare e arsytimit është 14 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale;
- (ix) Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton, sipas objektit të çështjes, si vijon:
  - a. kërkesa me objekt “*vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 4.7 ditë, më e shkurtër se

- afati procedural* 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale;
- b. kërkesa me objekt “*caktim mase sigurimi*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 2 ditë, *më e gjatë se afati procedural* sipas parashikimeve të nenit 244/1 të K.Pr.P i cili parashikon që vendimi duhet të jepet i arsyetuar, duke u tejkualuar afati 24 ore me vetëm 1 ditë, tejkualim i cili vlerësohet të jetë *i papërfillshëm*, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përllogaritjen e afatit;
  - c. kërkesa me objekt “*zëvendësim/revokim mase sigurimi*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 5 ditë, *e barabartë me afatin procedural* 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 dhe 260 të K.Pr.Penale;
  - d. kërkesa me objekt “*lejim/zgjatje afati përgjimi*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 1 ditë, *e barabartë me afatin procedural* 24 orë të parashikuar në nenin 222 të K.Pr.P;
  - e. kërkesa me objekt “*lejim kontrolli të vendeve*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 1 ditë, *e barabartë me afatin procedural* të parashikuar në nenin 202/a të K.Pr.P i cili parashikon që vendimi duhet të jepet i arsyetuar;
  - f. kërkesa të fazës së hetimit paraprak për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat të posaçëm për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 16 ditë, *më e shkurtër se afati procedural* 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.P;
- (x) Për çështje të kategorisë “seancë paraprake”, koha mesatare e arsytimit është:
- a. në çështjet me objekt “*dërgimin e çështjes në gjyq*”, 13 ditë, pra *më e gjatë se afati procedural* 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale, duke u tejkualuar ky afat vetëm 3 ditë;
  - b. në çështjet me objekt “*kërkesë për pushim procedimi*”, 30 ditë, pra *e barabartë me afatin procedural* 30 ditë të parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.P;
- (xi) Për çështje të kategorisë “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, koha mesatare e arsytimit është:
- a. për çështjet me objekt «*shtyrje e ekzekutimit të vendimit*», 15 ditë, pra *më e gjatë se afati procedural* 5 ditë, i parashikuar nga neni 476/3 i K.Pr.Penale;
  - b. për çështjet me objekt «*përjashtim gjyqtari*»<sup>103</sup>, 4 ditë, pra *më shkurtër se afati procedural* 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.P;
  - c. për kërkesat për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 14 ditë, pra *më shkurtër se afati procedural* 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 382/2 të K.Pr.P;

<sup>103</sup> pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017 i cili ka ndryshuar nenin 22 të K.Pr.P. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet se “3. Gjykata, pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos për kërkesën e përjashtimit brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës”, por ky afat lidhet me kohën e shqyrtimit të kërkesës dhe jo me afatin ligjor të arsytimit të vendimit.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij për këtë tregues shumë të lartë, duke argumentuar se *statistikat referojnë në datën kur sekretarja gjyqësore ka depozituar fizikisht fashikullin e gjykimit në kryesekretari, pasi të dhëna të plota statistikore dhe konkrete, nuk ka patur përgjatë periudhës ë vlerësimit lidhur me kohën e arsyetimit të vendimit, dhe për pasojë, statistikat kanë pasqyruar shënimet manuale nga sekretaria në librin e dorëzimit.*

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se:

- (vii) tejkalmimi i afatit procedural për nën kategorinë e çështjeve me objekt “*caktim mase sigurimi*”, me vetëm 1 ditë, përbën një tregues të papërfillshëm duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor të cilat mund të kenë ndikuar në afatin e dorëzimit të dosjes, duke konsideruar që ky afat i përket vetëm një pjesë të çështjeve të kategorisë “penale të hetimit paraprak” ndërkohë që për pjesën tjetër që përbën këtë kategori koha mesatare e arsyetimit rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural;
- (viii) tejkalmimi i afatit procedural 10 ditor, për kategorinë e çështjeve me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*” me vetëm 3 ditë, përbën një tregues të papërfillshëm, duke konsideruar që ky afat i përket vetëm një pjesë të çështjeve të kategorisë “penale seancë paraprake” ndërkohë që përpjesën tjetër që përbën këtë kategori dhe konkretisht çështjet me objekt “pushim procedimi/çështje”, koha mesatare e arsyetimit rezulton më e shkurtër se afati procedural;
- (ix) tejkalmimi i afatit procedural 5 ditor, për çështjet me objekt «*shtyrje e ekzekutimit të vendimit*», me 10 ditë, duhet vlerësuar duke konsideruar faktin që ky afat i përket vetëm një pjesë të çështjeve të kategorisë “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit” ndërkohë që për pjesën tjetër që përbën këtë kategori koha mesatare e arsyetimit rezulton më e shkurtër se afati procedural;

#### **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”, pasi vetëm për tre nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkualuar me 1 dhe 3 ditë, dhe për një prej tyre<sup>104</sup> afati procedural i arsyetimit është tejkualuar, ndërkohë që për të gjitha kategoritë e tjera afati i arsyetimit rezulton më i shkurtër dhe në një pjesë të tyre i barabartë me afatin procedural.

---

<sup>104</sup> Një prej nënkategorive të çështjeve “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit*”, sipas objektit të kërkesave.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.*

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

### **2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh<sup>105</sup>, duke përfshirë ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 3 seanca;
- (ii) për kategorinë “familjare me palë kundërshtare” është 2 seanca;
- (iii) për kategorinë “penale themeli” është 1.6 seanca;
- (iv) për kategorinë “penale kundërvajtje” është 1 seancë<sup>106</sup>;
- (v) për kategorinë “penale seancë paraprake” është 1.6 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim (16 çështje), rezulton të jetë **1.6 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore, pas ezaurimit të veprimeve përgatitore në çështjet civile dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale, si dhe duke përcaktuar provat që do të shqyrtohen në gjykim në urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet civile.

<sup>105</sup>Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për të gjitha çështjet. Për pasojë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit”, numri mesatar i seancave gjyqësore do të përllogaritet duke iu referuar 12 (dymbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim.

<sup>106</sup> Në këtë përllogaritje të numrit mesatar të seancave gjyqësore nuk janë përfshirë 2 çështje të kategorisë “penale kundërvajtje”, të përzgjedhura me short për vlerësim pasi ato janë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe kanë përfunduar me një seancë, referuar objektit të kërkimit të tyre i cili konsiston në miratimin e urdhrin penal.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si : për njoftimin e avokatit të caktuar kryesisht, për njoftimin e vendimit të fazës së parë të pjesëtimit për palët në mungesë, për shkak të kërkesave të palëve për arsye shëndetësore ose të tjera, për ti lënë kohë ekspertit për përgatitjen e aktit të ekspertimit, për përsëritjen e njoftimit të të pandehurit, për ti dhënë kohë mbrojtësit për tu njohur me aktet, për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarit në detyrë për arsye shëndetësore ose shkaqe të tjera objektive, për kryerjen e njoftimit të të paditurve me shpallje, etj. Në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive procedurale, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit së çështjes si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

#### **KONKLUZIONE:**

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 1.6 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

#### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve.

Në çështjet civile gjyqtari ka disponuar nëpërmjet akteve të njoftimit për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes dhe më pas ka disponuar me urdhër për kalimin e çështjes në seancë përgatitore. Pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrat për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 158/ç i K.Pr.Civile) gjyqtari ka disponuar me vendim për përcaktimin e provave që do të administrohen në gjykim.

Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtari ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës në kërkesat penale<sup>107</sup> ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli. Në çështjet penale me objekt “Miratimin e urdhrin penal” gjyqtari shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve, sipas parashikimeve të nenit 406/b, pika 1 të K.Pr.Penale<sup>108</sup>.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën përgatitore/gjyqësore, por ka treguar kujdes në marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtari tregon kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkaktun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa të deri në 15 minuta (të papërfillshme), dhe vetëm një numër i kufizuar seancash rezulton të kenë filluar me vonesa më tepër se 15 minuta, të cilat lidhen me organizimin dhe përgatitjen e sallës për gjykim ose të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse.

---

<sup>107</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 108, datë 21.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”.

<sup>108</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 44, datë 27.02.2018 dhe çështja që i përket vendimit nr. 121, datë 27.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore<sup>109</sup>.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Në çështjet penale aktet renditen duke filluar me *vendimin për caktimin e seancës gjyqësore/paraprake* për të vijuar me *aktet e shortit dhe akte të tjera të mbajtura nga administrata gjyqësore për dorëzimin e dosjes dhe provave materiale kur është rasti, njoftimet, kërkesat me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi përfundimtar*. Në çështjet civile aktet renditen duke filluar me *vendimin/urdhrin për caktimin e seancës përgatitore, vendim për përcaktimin e provave që do të merren në seancë gjyqësore, për të vijuar me aktet e shortit, kërkesë padia dhe provat, njoftimet, aktet e përfaqësimit, kërkesat me shkrim të palëve, konkluzionet përfundimtare me shkrim, procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore dhe vendimi përfundimtar*.

Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja, duke ndjekur kryesisht grupimin e akteve sipas llojit të tyre, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryerja nga gjyqtari gjatë gjykimit, konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten

<sup>109</sup> Përveç çështjeve të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi për të cilat nuk është mbajtur procesverbal për shkak të ritit të shqyrtimi.

të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, rezulton se renditja akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik të kombinuar me atë kronologjik brenda të njëjtës kategori. Kjo renditje e bën dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

#### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit, nga momenti i caktimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit të saj. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesëpatria, kërkesa penale, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore dhe gjyqësore, komunikimet shkresore me të tretët, njoftimet, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore dhe vendimet gjyqësore përfundimtare*).

Në dosjet penale, nuk rezulton të jetë administruar kopje e “Letrës së të drejtave” e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a<sup>110</sup>, 58<sup>111</sup>, 140 pg 1<sup>112</sup> dhe 137<sup>113</sup> i K.Pr.P. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.P subjekteve i janë garantuar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mos administrimi i

<sup>110</sup> Në nenin 34/a, pika 2 dhe 3 të K.Pr.P parashikohet se :” 2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. 3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.”.

<sup>111</sup> Neni 58 pika 2 i K.Pr.P parashikon se :” 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.”.

<sup>112</sup> Neni 140, pg 1 i K.Pr.P parashikon se : « 1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi.... »

<sup>113</sup> Neni 137, pg 1 i K.Pr.P parashikon se :” 1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë....”.



kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore dhe mospasqyrimi në këtë të fundit i komunikimit të letrës së të drejtave, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

#### **KONKLUSIONE:**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të “letrës të të drejtave” e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të për zgjedhura me short për vlerësim.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 8 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### **3.A Etika në punë**

##### **3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 2324/1 prot., datë 27.05.2021, rezulton se ndaj gjyqtarit {...} në periudhën e vlerësimit 2017-2019 nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka vlerësuar shumë të larta aftësitë e tij në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtarit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B Integriteti i gjyqtarit**

#### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, për gjyqtarin {...} nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa pranë ILD-së.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ-së me shkresën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton se: “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se për gjyqtarin {...}: a) Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.”.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

#### **KONKLUSIONE:**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në lidhje me treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

### **3.C Paanësia e gjyqtarit**

#### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUSIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, është paraqitur 1 (një) kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit, e cila nuk është pranuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtari ka paraqitur 32 (tridhjetë e dy) kërkesa për heqje dorë, të cilat 31 (tridhjetë e një) janë pranuar dhe 1 (një) prej tyre është rrëzuar.

#### **KONKLUZIONE:**

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është zero, duke qenë se e vetmja kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit është rrëzuar.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

### **4.A Aftësia e komunikimit.**

#### ***4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët, etj.*) dhe në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

#### ***4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar.**

##### ***4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

##### ***4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtari ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

#### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019<sup>114</sup>, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 10 aktivitete trajnuese të cilat kanë zgjatur për 20 ditë kalendarike dhe janë zhvilluar nga data 15-16 qershor 2017 deri në datë 2-3 dhjetor 2019.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 10 aktivitete të zhvilluara për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është 20 ditë, brenda marzhit të përcaktuar nga ligji 15-120 ditë për 3/vjet, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

#### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e gjyqtarit {...} në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses apo trajnueses. Po ashtu nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në udhëheqjen e kandidatëve për magistratë gjatë periudhës së stazhit profesional, por njëkohësisht nuk rezultojnë të dhëna për zhvillimin e këtij aktiviteti pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku ai ka ushtruar funksionin në periudhën e vlerësimit.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin

<sup>114</sup>Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari referon se ka përmbushur detyrimin për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës gjatë gjithë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019.

për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues pranë Shkollës së Magjistraturës apo të ketë pasur mundësi të udhëheqë kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se për këtë tregues, duke qenë se nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit, ai pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara fillimisht në Raportin Analitik, nuk rezultonin të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) nga dosja personale e gjyqtarit apo të dhëna nga burimet e vlerësimit, në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Pasi u njoh me projektraportin e vlerësimit, prej gjyqtarit u paraqitën prova të reja, konkretisht u paraqit e administrua në dosjen e vlerësimit vërtetimi Nr. 239 Prot dt. 21.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, nga rezultonte angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, të kontributit në ndjekjen dhe udhëheqjen e praktikave mësimore të studentëve të vitit të tretë të Universitetit Ndërkombëtar Strugë, Fakulteti i Shkencave Juridike; Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë; Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Drejtësisë, Dega Drejtësi; Kolegjit Universitar të Biznesit Tiranë, Fakulteti i Drejtësisë; Albanian University Tirane, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Dega Drejtësi.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.



## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari {...} të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale prandaj pikëzohet me 5 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

### 4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

## KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE  
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

## **REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>	
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>	
<b>Treguesit</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>	<b>Pikët</b>	<b>Të dhëna për metodologjinë</b>		
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë	

		gjqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>98</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	0-10%	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë

<b>punë</b>		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i	+99%	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81%- 2 pikë

		gjqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe	1.Të dhënat statistikore/aktet e	1-3 seanca dhe/ose shkallë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e</b>

<b>kryer procedural gjyqësore</b>	kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	shumë e lartë e aftësisë		<b>aftësisë së gjyqtarit:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Mbi mesataren	8	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë

					Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë



<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

		përzgjedhura me short			
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>2. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> <li>3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim</li> <li>4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</li> </ol>	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>2. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> <li>3. Të dhënat për verifikimin e ankesave</li> </ol>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>2. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> <li>3. Të dhënat për verifikimin e ankesave</li> </ol>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë

<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	15-120 ditë (periudha 3/vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

		profesionale të saj			
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>391</b>			
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>		<b>Shkëlqyeshëm</b>			

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**